



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS**



**PLANI I PUNËS SË DREJTORIS SË SHËNDETËSIS DHE MIREQENJES
SOCIALE**

PËR VITIN 2024

MALISHEVË



Republika e Kosovës-Komuna e Malishevës
QKMF “Dr. Shpëtim Robaj” Malishevë



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2024

Nga: Dr. Afrim Krasniqi Drejtor i QKMF-së “Dr. Shpëtim Robaj” në Malishevë

Për: Kryetarin e Komunës së Malishevës z/. Ekrem Kastrati dhe
Drejtorin e DSHMS-së Z/. Hajdin Berisha

LISTA E MATERIALEVE NGA DONATORET

Nr.	Aktiviteti	Fillimi i aktivitetit	Përfundimi i aktivitetit
1	Ndërtimi i QMF Kijevë	05.04.2024	05.12.2024
2	Furnizim me paisje mjekësore	01.08.2024	29.11.2024
3	Furnizim me material laboratorik	09.09.2024	05.11.2024
4	Furnizim me filma për rentgen	05.11.2024	05.12.2024
5	Furnizim me oksigjen medicinal	02.02.2024	04.03.2024
6	Furnizim me materjal për stomatologji	12.03.2024	09.04.2024
7	Furnizim me barna për nevojat e urgjencës së QKMF-së	03.05.2024	04.06.2024
8	Servisim i paisjeve mjekësore (laborator,rentgen,memografi,ultrazë)	24.04.2024	10.05.2024

9	Blerja e mobileve	03.07.2024	01.08.2024
10	Furnizim me kompjuter për nevojat e QKMF-së	07.03.2024	04.04.2024
11	Makine Fotokopje	02.05.2024	06.06.2024
12	Paisje specifike mjeksore	07.03.2024	09.04.2024
13	Paisje të tjera për nevoja të QKMF-së	05.06.2024	11.07.2024
14	Furnizim për zyre	25.07.2024	22.08.2024
15	Furnizim me dru për ngrohje	25.07.2024	22.08.2024
16	Karburante për vetura-naftë për gjenerator	02.02.2024	14.03.2024
17	Shërbime kontraktuese	20.06.2024	25.07.2024
18	Furnizime mjeksore	02.08.2024	20.09.2024
19	Mirëmbajtje e objektivave shëndetësore	24.04.2024	10.05.2024

Malishevë, 05.12.2023

Objektivat (Çka dëshironi të arrini)	Veprimi /Aksioni (Cilat janë veprimet për të i përmbyshur objektivat)	Afati kohor për përfundimin përmbyshjen e aktivitetit	Kostoja financiare	Përgjegjësia (Kush e bën realizimin e implementimit)	Rezultatet e pritura (Çfarë efekti do të ketë veprimi	Vështirësit/sfidat (psh. Buxheti, administratë, Përsonei	Vërejtjet
SHËRBIMET SOCIALE 1.Avansimi i rregullimit të infrastrukturës juridike	Në vitin 2024 shërbimi social në QPS-Malishevë do të angazhohet për implementimin e rregullativës ligjore dhe udhëzimeve administrative, dhe plotësimin e ndryshimeve të ligjeve për shërbime sociale. -Ligji për shërbimet sociale familjare Nr.02/L-17, ligji për familjen i Kosovës Nr.2004/32, ligji i Procedurës Penale, Kodin Penal për të mitur i Kosovës. Pos Ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në QPS do të zbatohen edhe shumë ligje dhe udhëzime	Për të gjitha Ligjet, Rregulloret, Udhëzimet Administrative si dhe Doracakët e ndryshëm është shumë e nevojshme që IPS në Prishtinë apo nga ndonjë asociacon ligjor që merret me interpretimin e tyre të organizohen trajnime me punëtorët e QPS –ve. Gjatë tërë vitit 2024	Buxheti I Kosovës si dhe donator të ndryshëm Komuna	DPSF, DSHMS Zyra Ligjore e MD, Këshilli i Lartë i Drejtësis si dhe IPS në Prishtinë dhe Qendra sociale.	Familjet që për momentin kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme të fitojnë përkrahje materiale nga 100 euro në muaj, ngase kanë mbetur të marginalizuar si dhe të ngritet niveli profesional i OJQ-ve dhe i zyrtarve të shërbimeve sociale. Po ashtu edhe Ligji 04/L-	Pa trajnime adekuate mund të vijë deri te përzierja e Ligjeve që kanë qenë në fuqi të aplikimit dhe Ligjeve që janë tani të aplikueshme. Problem Bugjeti i limituar dhe nuk mund të kryhen shërbimet që nevojitet.	Ligjet të cilat nuk janë të aplikueshme të revidohen nga përdorimi me anë të Udhëzimeve të posaqëme Administrative apo në formë të tjera .

	administrative. P.sh. Udhëzimi administrativ Nr. XX/2021 për përbërjen dhe funksionimin e panelit për strehim familjar dhe adoptim. Udhëzimi administrativ nr. 10/2014 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet. Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2014 për punën dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore ngecje në zhvillim mendor në Institutin Special në Shtime,	Gjatë tërë vitit 2024			092 për të verbër ju jep mundësi familjet që kanë fëmijë të verbër të marrin pension në vlerë prej 125 euro kurse me përcjellës 125 euro. Totali: 250 euro në muaj.		
--	---	-----------------------	--	--	---	--	--

	dhe në shtwpiw me baze ne komunitet. Puna në QPS është shumë dimensionale në të gjitha format për mbrojtjen e qytetareve duke i respektuar ligjet në fuqi. Ligji nr 06/L-084 për mbrojtjen e femijes. Ligji nr.03/L-182 për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ligji nr.05/L-067 për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik.						
2.Plotësimi i Standarteve sa i përket shërbimeve sociale.	Në punën e QPS do të respektohet Legjislacionin në fuqi dhe shumë Konventa ndërkombëtare që gjejnë zbatim në punë e përditshëm të Organit të Kujdestaris. Gjatë tër vitit 2024 çdo ndryshim dhe rregullore do të organizohen trajnime,tryeza të rrubullakëta për	Afati i përhershëm Gjatë tërë vitit 2024	Buxheti i Kosovës		Do të avansohet rregullativa ligjore dhe zyrtarë do të respektojnë me përpikëri ligjet në fuqi .	Të jemi të kujdesëshem në ato standarte që janë të aplikueshme dhe që gjejnë zbatim në opinion.	

	avancimindhe ofrimin e shërbimeve sa me efikase pran qytetarve conform standarteve të aplikushem për të gjithë nevojtarët pamvarsisht nga përkatësia nacionale,fetare gjinor etj.						
3.Mbrojtja e femijëve pa kujdes prindror. - Realizimi i bashkimit familjar.	Të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative që janë në fuqi implementohen me përpikmëri nga ana e Organit të Kujdestaris për mbrojtjen dhe diskriminimin e formave të ndryshme nga familja dhe shoqëria si për ata pa kujdes prindror ashtu edhe me prindër dhe bëhet e mundur edhe bashkimin familjar. Ky parim do të vazhdoj gjatë gjithë vitit 2024	Afati është i përhershëm gjatë tërë vitit 2024	Buxheti I Kosovës	DPSF, QPS, Komuna DSHMS,OJQ etj.	Veprimi Bashkimi familjar të jetë i realizueshëm vetëm aty ku vertet ka nevojë në bazë të rregullativës ligjore.	Gjatë qështjës së bashkimit Familjar duhet të jemi shumë të kujdeshëm që ky bashkim mos të bëhet pa u përfillë procedurat e rregullta , nga se mund të vije deri te një bashkim familjar masive dhe I qendrushem.	

--	--	--	--	--	--	--	--

-4. Strehimi Familjar	Edhe për strehimin familjar do të shfrytëzohen aktet ligjore , Udhëzimet Administrative si dhe Doracakët e ndryshëm ku bëhet fjalë për strehimin familjar. Strehimi Familjar do të realizohet sipas planifikimit për dy kategori siq janë: Fëmijët e braktisur dhe fëmijët e keqtrajtuar. Sipas vendimeve të QPS – së do të bëhet pagesa permanente për familjet strehuse në	Afati do të jetë i lidhur gjatë tërë vitit kalendarik 2024	Buxheti I Kosovës, Donatorët dhe Buxhet I Komunës	DPSF,DSHS,Zyra ligjore e MD Këshilli I Lartë I Drejtësis ,IPS në Prishtinë,QPS dhe OJQ,DSHMS Dhe Komuna	Fëmijët e braktisur dhe fëmijët e keqtrajtuar të u mundësohet një ngrohëtsi familjare për mes veprimt strehim familjar .		Kategoria e Fëmijëve të keqtrajtuar është shumë më e nevojëshme që të bëhet jo në familjet strehuse por në strehimorët për mbrojtjen e fëmijëve .
------------------------------	--	--	--	---	--	--	--

	shumën mujore prej 350 € për fëmijën e cekur më lartë .Fëmijë me aftësi të kufizuar të braktisur pagesa 450 €. Për fëmijët jetim dhe pa dy prindër që janë strehuar te të afermit e tyre ,pagesa mujore do të bëhet në shumën prej 100 euro sipas udhëzimit Administrativ						
	Këtë vit në QPS Malishevë do të mbajm një tryezë të rrumbullakët ku do të marrin pjesë Kryetari I komunes dhe disa drejtori ,Terre des homes’ . OFAP organizarta qe merret me trajnimin e familjeve strehuse dhe DPSF-ja. Kujdesi ndaj përsoneve të moshes madhore						

	qe i eshte hequr zotsia e veprimit, Kujdestaria per raste te veqanta						
--	---	--	--	--	--	--	--

5. Birësimi (Adoptimi)	Kategoria e Birësimit (Adoptimi)do të shfrytëzohen aktet ligjore e nënligjore si dhe Udhëzimet Administrative dhe Doracakët e ndryshën ku flitet për këtë kategori. Birësimi (Adoptimi të fëmijëve të braktisur do të i ipet prioritet edhe në vitin 2024.Moto e punës së shërbimeve sociale pran QPS në Malishevë do të jetë Familje për Fëmijë”, e jo “Fëmijë për Familje”që ky Standartë sot është shumë i preferuar .Do të respektohet Konventa e Hagës . Për Adoptim ndërkombëtar do të bëhen të gjitha orvajtjet që fëmiu pa kujdes prindror , të mbetët në vendin e origjinës , pra në Kosovë, por nëse një gjë e tillë nuk është e mundur dhe nëse vlerësohet se është në interesë të fëmiut do	Afati do të jetë i lidhur tërë vitit kalendarik 2024	Buxheti i Kosovës , Donatorët	DSHS , QPS ,DSHMS sidomos Zyrtaret e shërbimeve sociale si dhe OJQ vendor e Nderkmtare		Kategoria e Adoptimit është një kategori ku zyrtaret e shërbimeve sociale duhet të jenë shumë të vemendëshem . Një numër i madhë i punëtorve tanë në botën e jashtme kanë dëshirë që të bëjnë adoptime për fëmijët e të afërme ku duhet të kemi kujdes që fëmijët mos të dalin jashtë vendit. Ku është e precizuar edhe në ligjet e Aplikushme në Kosovë	
-----------------------------	--	--	-------------------------------	--	--	--	--

	të krijohet edhe adoptimi Nderkombëtar përmes Panelit për vendosjen e adoptimit nderkombëtar.						
--	---	--	--	--	--	--	--

6.Femijët e prinderve të shkurorëzuar apo të ndar,dhe besimi i femijëve	Kategoria e prindërve të shkurorizuar apo të ndar, dhe besimi i femijëve do të përfillet një legjistacion i aplikueshëm për këtë kategori , sidomos do të veprohet sipas ligjit për familjën i Kosovës , Ligji Nr.2004/32 . Për këtë kategori do të i përgjigjemi çdo here me kohë gjykatës ,nëse ajo kërkon që vlerësimi të bëhet nga QPS-ja	Gjatë tërë vitit 2024		Gjykatat kompetente dhe QPS.			Proqesi i shkurorizimev e është duke u bërë një dukuri jo e mire. QPS në Malishevë do të angazhohet që në periudhën e pajtimit të bashkëshortëv e të bën pajtimin e tyre dhe mos të vije gjërë te ndarja e tyre
---	---	-----------------------	--	------------------------------	--	--	---

Objektivat (Çka dëshironi të arrini)	Veprimi /Aksioni (Cilat janë veprimet për të i përmbushur objektivat)	Afati kohor për përfundimin përmbushjen e aktivitetit	Kostoja finaciare	Përgjegjësia (Kush e bën realizimin e implementimit)	Rezultatet e pritura (Çfarë efekti do të ketë veprimi	Vështirësit/sfidat (psh. Buxheti,administrate, Përsonei	verejtjet
NDIHMAT SOCIALE 1.Përkrahja finaciare e familjeve në gjendje të rendë sociale dhe ekonomike të cilat i plotësojnë kriteret dhe kushtet që i parashh Ligji për Skemën e Ndihmave Sociale në Kosovë nr.2003/15 si dhe zbatimi i këtij ligji Si dhe Plotësim Ndryshimi I ligjit Nr.04//L-096 I ligjit nr.2003/15	Identifikimi dhe përzgjedhja e familjeve të varfura në Kosovë nga ana Qendrës për Punë Sociale .	Gjatë tërë vitit 2024 Ngritja e Ndihmave Sociale për 20%	Buxheti I Kosoves	MFPT. DPSF QPS,	Përzgjedhja e familjeve që kanë nevojë për ndihmë të bëhet që ndihma të orijentohet aty ku ka vërtet nevojë për ndihmë , si dhe eliminimi nga skema e familjeve që nuk kanë nevojë për ndihmë.	1. Numri i madhë i aplikanteve si për kategorin e pare dhe të dytë . 2. Ankesat nga aplikantet ne dy kategorit.	Ankesat drejtohen në DPSF në Prishtinë

2. Aplikimi i rregullativës ligjore për Skemën e ndihmave Sociale siq janë: Ligji nr.2003/15 mbi Skemën e Ndhmave Sociale në Kosovë. Ligji për menaxhimin e financave publike nr.2003/2 etj.	Për zbatimin më të mire të Ligjeve të aplikueshme në Skemën e Ndhmave Sociale duhet të konsultohen edhe Rregullorja zbatuese NR2003/xx, mbi zbatimin e Ligjit për Skemën e Ndhmave Sociale nr.2003/15 - Udhëzimi Administrativ për verifikimin e gjendjës materiale në familjet që aplikojnë për ndihmë sociale. Si dhe ndryshim plotësimi I ligjit nr.04/L-096 Po ashtu edhe implementimi I ri I sistemit të bazës së të dhënave ne niveli qendror.	Gjatë tërë vitit 2024	Buxhet I Kosovës	MFPT, DMS , DNS si dhe QPS	Përzgjedhja bëhet sipas kriterëve të përcaktuar në ligj.	Paraqitjen e shumë paknaqësive te familjet të cilat kanë qenë shfrytëzuese e me aplikimin e ligjit mund të eliminohen .	
--	---	-------------------------------------	--------------------------------	--	--	---	--

Plani i veprimit për Skemën e ndihmave sociale	1.Zyrtarët e SNS-i të janë më vigilent në përzgjedhjen e familjeve, të organizohen trajnime sa më adekuate, dhe monitorimi të bëhet në kohë të duhur, dhe udhizimet e tyre të janë sa më të favorshme për nëpunësit dhe vet shfrytëzuesit e asistencës sociale. Këtu përfshihet Verifikimi,Riverifikimi Në teren në familjet që aplikojn në NS ku me vete jan të paisur me formular dhe dokumentacion dhe te qdo aplikant qe I bëhet vizita plotësohet dhe shenphen të gjitha gjësendet dhe të mirat material ku vlersohen me poena dhe ne menyrë elektronike bëhet poentimi I aplikantve	Sipas nevojës	Buxhet I Kosoves	MFPT, DPSF dhe QPS	Aplikimi i drejtë i Skemës së Ndhimave Sociale	Paraqitja e shumë paknaqësive dhe numri i madh i ankesave të qytetarët	
---	--	----------------------	-------------------------	---------------------------	---	---	--

Objektivat (Çka dëshironi të arrini)	Veprimi /Aksioni (Cilat janë veprimet për të i përmbushur objektivat)	Afati kohor për përfundimin përmbushjen e aktivitetit	Kostoja financiare	Përgjegjësia (Kush e bën realizimin e implementimit)	Rezultatet e pritura (Çfarë efekti do të ketë veprimi	Vështirësit/sfidat (psh. Buxheti,administrate, Përsonei	vërejtjet
<u>1.Administrata dhe financat-</u> Buxheti dhe nevojat e QPS-së për funksionim të rregullt ,duke përfshir pagesen e shpenzimeve për shërbimet publike,mirmbajtjen e objektit ,furnizimin me derivate ,mirmbajtjen e automjeteve dhe inventarizimit të QPS-së.	Pagesat dhe shpenzimet per rryme, PTK,uji,mbeturina dhe pagesa tjera mallra dhe shërbime.	Gjatë tërë vitit 2024	Sipas nevojave	QPS,DSHMS, Thesari në Komunë	Në të mire të qytetarve per shërbime .	Shpresoj se nuk do te kemi vështirësi gjatë Ekzekutimi të pagesave.	

2.Prioriteti Kryesor për vitin 2024 I QPS.	1.Ndertimi i Objektit për QPS. 2.Rritja e pages për zyrtaret që mbajnë kujdestari për raste të ndryshme. 3.Sigurimi i nje Makine për nevojat e QPS-së. 4. Ndertimi i shtepis me bazë në komunitet, për personat me aftesi të kufizuara dhe me retardime mendore. 3.Pagesen për vërtetima,dëshmi, Rgjistrime etj. Ku 50% mbeten si Të Hyra vetanake në QPS për nevoja emergjente dhe 50% të Hyra në Komunë	Gjatë vitit 2024	Është I domosdoshëm Codi I shërbimeve Sociale 75561	QPS,Komuna Drejtoria e financave,Ministria e financave Ad.-financa në QPS Dhe Drejtoria per Buxhet dhe Financa në Komunë	Në të mir të institucionit Puna në QPS bëhet ma e mirë Në të mire Qytetarve dhe raste tjera si dhuna në familje,braktiseja e fëmijëve nëpër spitale etj.	Nuk besoj që do të ketë. Nuk besoj që do të ketë. Nuk do të ketë	
--	---	-------------------------	---	---	---	---	--

P.S.Sherbimi profesional i Qendres për punë sociale në Malishevë, gjatë vitit 2024 do të angazhohet edhe në punë dhe detyra tjera, me kategori të ndryshme, si janë: Të miturit me nevoja të veçanta, të rriturit me retardime mentale, të moshuarit pa kujdesje familjare, dhe raste të tjera, të cilat do të bëjnë përpjekje maksimale në ndihmë këtyre kategorive. Gjatë këtij viti, sipas planit dhe programit të punës do të bëhen shumë vizita familjare, do të bëhet përcjellja e fëmijëve nën kujdestari, ku edhe përcillet detyra e kujdestarit, do të angazhohemi edhe në regjistrimin e fëmijëve të cilët nuk janë regjistruar në librat amë të të lindurëve. Po ashtu, kemi një numër të prindërve të cilët kanë të caktuar sipas Aktvendimeve të Gjykatave kontaktet e prindërve me fëmijë sipas planit të paraparë, si dhe do të përcjellim masen edukative ndaj të miturëve të cilëve do të u propozojmë masa edukative. Për herë për punë dhe angazhimin tone, dhe për vështirësitë të cilat na paraqiten do të bashkëpunojmë dhe do të konsultohemi me Divizionin e shërbimeve sociale pranë DPSF-së dhe me IPS-ën, me Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe me të gjitha QPS-ët me të cilat angazhohemi në bashkëpunim me kryerjen e lëndëve të ndryshme.

Angazhim të posaqëm në QPS do të ketë edhe shërbimi i SNS-it . Ky shërbim do të kryen detyrën me shumë përgjegjësi . Do të angazhohet në aplikimin e rregullativës ligjore në Skemën e Ndhimave Sociale . Ndhima sociale do të i ipet atij që vertet është për ndihmë duke e përfillë edhe kriteret e Ligjit mbi Skemën e ndihmave sociale. Do të bëhen verifikimet në teren dhe në formë të komisionit do të shifet se a është për ndihmë apo jo . Ky shërbim do të bënë një bashkëpunim të mirë edhe me organet Komunale sidomos me Drejtorinë e ekonomisë dhe financave, zyrën e ofiqarisë , Drejtorinë për Kadastër dhe prone , Notariën , gjykatat etj. Kuptohet që Plani i Veprimet që e ka miratuar MPMS dhe DPSF në Prishtinë do të jenë udhërrefyes për punën tone . Në zbatimin e këtij plani do të paraqiten vështirësi dhe shumë shfrytëzues do të jenë të pa knaqur , kështu që edhe ankesave të qytetarve do të u kushtojmë një rendësi të veçantë. Do të kërkojmë që edhe nga Kuvendi Komunal në Malishevë, që familjet e varfura që nuk gëzojnë asistencën sociale përkrah të procedurave ligjore të u mundësohet ndonjë ndihmë momentale në të holla ose ndonjë ndihmë tjetër .

Një angazhim të veçantë kemi edhe në Shërbimin e Ad-Financës ku përmes këtij shërbimi bëhet funksionimi i të gjitha shërbimeve, planifikimi i buxhetit të QPS, personelit, pushimet e punëtorëve, mirëmbajtja e objekteve, veturave, derivateve, pagesat, shpenzimet e shumta shërbime që kryhen në kuadër të Ad-financave.

Dhe së fundi pagesat për dokumente që i lëshon QPS-ja për shërbim ndaj qytetarve ku 50% të mbeten në QPS për nevoja të qytetarve dhe 50% të shkojnë në Buxhetin e komunës.

Vlen të theksohet pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Taksa-Ngarkesa dhe Gjoba e miratura nga Asambleja Komunale për ofrimin e shërbimeve të qytetarve për rregullimin e dokumentacionit, që QPS ka lëshuar vertetima, dhëshmi etj. Qytetarët kanë bërë pagesën në Arkë në Komunë dhe si të Hyra Vetanake kemi mbledhur shumën prej 729 euro, deri në Muajin Maj 2021 për arsye se nga muaji MAJ janë bërë pagesat për rregullimin e dokumentacionit.

Gjithashtu kemi planifikuar sjelljen e një veture për nevojat e dy shërbimeve që funksionojnë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, pasi që është e pamundur të kryhen punët ashtu si duhet vetëm me një veturë.

Malishevë, 2024

DREJTORI
Shqipron Berisha
